

V E N D I M
Nr.39, datë 16.10.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Veli Budo,	Anëtar
Zija Vuci,	Anëtar
Alfred Karamuço,	Anëtar
Franc Jakova,	Anëtar
Hilmi Dakli,	Anëtar

me sekretare Drita Filto, në datën 14.10.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.45 Akti që i përket :

K Ë R K U E S E : PARTIA E DJATHTE DEMOKRATE, e përfaqësuar nga Z.Agim Zeka.

PALE E INTERESUAR : KESHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.

O B J E K T I

- Partia e Djathtë Demokrate, fillimisht është përjashtuar nga propaganda televizive, nësa më vonë nuk i është kompensuar koha e kësaj propagande;

- Është përjashtuar pa të drejtë nga përfitimi prej fondit të shtetit për fushatën elektorale parashikuar nga neni 49 i Ligjit “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”;

- Kërkohet shpallja si antikushtetuese e antiligjore pjesmarrja e organeve shtetërore dhe e personave të huaj në propagandën elektorale.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Përhershëm i Zgjedhjeve me shkresën nr. 251, datë 8.10.1996, ka urdhëruar Drejtorinë e RTV-së për planifikimin e transmetimit të aktiviteteve të Partive pjesmarrëse në Zgjedhje, ku përfshihet edhe PDD-ja.

Përsa i përket pretendimit për kompensimin e kohës së kaluar para datës 8.10.1996 çështja nuk përbën objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese. Kërkuesi ka të drejtën t’i drejtohet Komisionit Qendror të Përhershëm të Zgjedhjeve, aktet e të cilit ankimohen në Gjykatën e Kasacionit.

Pretendimi se përjashtimi nga fondi i shtetit për fushatën elektorale, bie në kundërshtim me nenin 49 të Ligjit “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”, nuk është i bazuar. Sipas kësaj dispozite, shuma e akorduar nga buxheti i shtetit për partitë politike, që marrin pjesë në zgjedhje, jepet në përputhje me përqindjen e votave që do të fitojë secila parti në zgjedhjet për Këshillin e rrethit. Nuk do të përfitojnë nga kjo ndihmë, ato parti politike që në shkallë vendi nuk arrijnë të fitojnë 2% të votave për këshillin e rrethit.

Kriteret e mësipërme për ndihmat financiare janë caktuar në harmoni me dispozitën e nenit 22 të Ligjit “Për partitë politike”.

Edhe përsa i përket shumave në të holla që u jepen në formë paradhënie partive politike, janë caktuar kriteret në paragrafin e fundit të nenit 49 të Ligjit të mësipërm. Këtë paradhënie e përfitojnë vetëm ato parti të cilat në zgjedhjet e fundit të pushtetit

lokal kanë fituar më shumë se 1% të votave të këshillit të rrethit, duke u detyruar këto t’i kthejnë shumat e marra nëqoftëse nuk i përmbushin kushtet e parashikuara në paragrafin e mësipërm.

Caktimi i këtyre kriterëve dhe kushteve për përfitimin dhe kthimin e shumave të marra në formë paradhënie nuk çënon ndonjë të drejtë kushtetuese të kërkuesit si subjekt elektorale. Paradhënia nuk përbën ndihmë në kuptim të ligjit “Për partitë politike” dhe atij “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”.

Si rrjedhojë, kufizimi në dhënien e shumave si paradhënie nuk çënon të drejtat e partive politike për ndihmë nga shteti.

Lidhur me kërkesën për shpalljen antikushtetuese e antiligjore të pjesmarrjes së disa organeve shtetërore në propagandën elektorale për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal, Gjykata e çmon të nevojshme të theksojë se për pjesmarrjen e Presidentit të Republikës, e Kryetarit të Kryesisë së

Kuvendit Popullor, Kryetarit të Këshillit të Ministrave, si dhe e deputetëve, në propagandën e elektorale nuk ka ndalim kushtetues ose ligjor.

Me ligjet kushtetuese dhe me ligje të veçanta janë përcaktuar organet dhe subjektet shtetërore që janë të depolitizuara e të departizuara e që si rrjedhojë, u ndalohet të marrin pjesë aktive në fushatën elektorale.

Kështu, sipas nenit 6 të Ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese” nenit 26, paragrafi i fundit , i ndryshuar me Ligjin kushtetues nr. 7558, datë 9.4.1994 si dhe dispozitave të Ligjit nr. 7492, datë 8.6.1991 “Për departizimin dhe depolitizimin e disa organeve shtetërore”, nuk ka asnjë ndalim që organet e subjektet shtetërore të sipërpërmendura të marrin pjesë në propagandën zgjedhore me cilësinë e përfaqësuesve të forumeve të ndryshme politike.

Përsa i përket pretendimit për pjesëmarrjen aktive të të huajve në propagandën zgjedhore, në kundërshtim me nenin 46 , paragrafi i parë, të Ligjit “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”, pala kërkuese duhet t’i drejtohet Komisionit Qendror të Përhershëm të Zgjedhjeve, i cili është ngarkuar me mbikqyrjen e zbatimit të përpiktë të këtij ligji (neni 30) .

PËR KËTO ARSYE ,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 24 të Ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991”Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

V E N D O S I :

Rrëzimin e kërkesës së Partisë së Djathtë Demokratike.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më datë 16.10.1996